



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

Nr. _____.

Data: 30.04.2025

Mitrovicë Veriore.

Në bazë të nenit 12, paragrafi 2, pika d, nenit 40, paragrafi 2, pika b dhe c të Ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale, nenit 20 dhe nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr.03/L-048, Statutit të Komunës së Mitrovicës Veriore Nr.10-030/01-0007269/24 të datës 28.06.2024, si dhe Propozim-Vendimit Nr. 03-030/01-0006329/25 të datës 23.04.2025, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 30.04.2025, sjell këtë:

V E N D I M

Për Bartjen e Mjeteve nga viti 2024 në vitin 2025

1. MIRATOHET Propozim-Vendimi për bartjen e tejkalimit të planit të THV 2024 dhe bartjen e THV 2024 të pashpenzuara.
2. Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet bartja e të hyrave vetanake nga viti 2024 në vitin 2025, në shumën totale prej **12,513.84 €**, respektivisht:
 - Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2024 është në vlerë prej **588.34 €** (nga të hyrat vetanake komunale-fondi 22), si dhe shuma e pashpenzuar në vlerë prej **500.00 €** (nga fondi 21);
 - Tejkalimi i planit për të hyra vetanake në vitin 2024 është në vlerë prej **11,425.50 €**.
3. Mjetet e bartura nga viti 2024 do të destinohen në kategorinë ekonomike-**Investime Kapitale**, përkatesisht për projektet si më poshtë:
 - Në nënprogramin 18198-Infrastruktura Publike do të alokohet shuma prej **7,000.00 €** për projektin: **“Ndërtimi dhe vendosja e monumentit me mbishkrimin Mitrovica”-Projekt i ri.**
 - Në nënprogramin 66195-Planifikimi Hapesinor dhe Rregullativ-do të alokohet shuma prej **5,513.84 €**, për projektin: **“Blerja e kompjutereve për Drejtorinë e Urbanizmit”-Projekt i ri.**
4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa e arsyetimit të projekteve kapitale si më sipër.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet, Financa dhe Zhvillim Ekonomik.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyren e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

Nedžad UGLJANIN

Mitrovicë Veriore

Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës Veriore

Dorëzohet:

1x1 Kryetarit të Komunës

1x1 MAPL

1x1 Anëtarëve të komisionit

1x1 Arkivit

Arsyetim

Projekti “Ndërtimi dhe vendosja e monumentit me mbishkrimin Mitrovica”. – Projekt i ri-parasheh ndërtimin dhe vendosjen e pikës simbolike identifikuese me emrin “Mitrovica” në hapsirën publike. Projekti është promovimi i imazhit të qytetit, krijimi i një pike referimi për banorët dhe vizitorët, si dhe fuqizimi i identitetit urban dhe kulturor të qytetit.

Projekti “Blerja e kompjuterëve për Drejtorinë e Urbanizmit” – Projekt i ri-parasheh blerjen e kompjuterëve profesional për drejtorinë e urbanizmit, të dedikuar për përdorim në programe të tjera të avancuara për planifikim hapsinor dhe inxhinieri.

Dorëzohet:

1x1 Kryetarit të Komunës

1x1 MAPL

1x1 Anëtarëve të komisionit

1x1 Arkivit